

Financa
Dhuf



Nr. 1302 Prot
Dt. 03.04.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE



5745
Nr. Prot.

Tiranë, më

Lënda: Dërgohen mendimet mbi raportin vjetor të monitorimit të buxhetit 2022

Kryetar i Bashkisë

MIRDITË

Z/ZNJ.

NDREC DEDAJ

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr. 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", bashkëlidhur ju dërgojmë komentet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi raportin vjetor të monitorimit të buxhetit të vitit 2022.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Risena Xhaja



KOMENTE TË PËRGJITHSHME
mbi raportin e monitorimit të vitit 2022
për Bashkinë MIRDITË

1. Vlerësim i përgjithshëm

Monitorimi, është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Menaxhimi i shpenzimeve vendore është i rëndësishëm me qëllim realizimin e produkteve të parashikuara, brenda limitit të miratuar të shpenzimeve për çdo program buxhetor. Nëpërmjet monitorimit të zbatimit të buxhetit është e rëndësishme që të sigurohet informacion i plotë në lidhje me performancën e shpenzimeve dhe realizimin e produkteve. Monitorimi i objektivave kryhet bazuar në treguesit përkatës të performancës që jepen kryesisht në nivel produkti, ndërsa monitorimi i produkteve realizohet në sasi dhe në vlerë. Monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Bashkia Mirditë e ka dorëzuar raportin mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit vjetor 2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr.815 Prot., datë 27.02.2022, brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Raporti i monitorimit Bashkisë Mirditë për buxhetin e vitit 2022 është shoqëruar me një relacion shpjegues dhe analizë të detajuar si dhe të gjitha anekset e tij.

2. Karakteristikat kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat

Për vitin 2022, Bashkia Mirditë ka paraqitur një pasqyrë të detajuar të planit të të ardhurave të veta sipas llojit si dhe burimeve të tjera të financimit. Gjatë vitit 2022 bashkia Mirditë ka planifikuar 75,000 mijë lekë të ardhura dhe ka realizuar 63,881 mijë lekë pra 85 % të planifikimit. Transferta e kushtëzuara të akorduara për bashkinë Mirditë gjatë viti 2022 janë në shumën 1,598,904 mijë lekë, ku fondet e rindërtimit zënë pjesën më të madhe, dhe realizimi i tyre është 97%. Referuar burimeve të veta të buxhetit vendor (nga transfertat e pakushtëzuara, transfertat e pakushtëzuara sektoriale dhe specifike, si dhe trashëgimia nga vitet e mëparshme), që rezultojnë në plan 514, 480 mijë lekë dhe realizim 433,515 mijë lekë, vërejmë se hapësira që zënë të ardhurat e veta në totalin e burimeve buxhetore për këtë bashki është shumë e ulët, vetëm 14.7% që tregon varësinë e kësaj bashkie nga buxheti qendror. Një raport i vogël i realizimit të të ardhurave të veta do të jetë një shkak i rëndësishëm për varësinë e kësaj bashkie nga të ardhurat e buxhetit qendror por edhe për krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe uljen e efektshmërisë së menaxhimit të financave publike nga Bashkia Mirditë.

Shpenzimet

Sipas raportit të monitorimit rezulton se Bashkia Mirditë, për vitin 2022 administron dhe menaxhon fondet publike sipas programeve buxhetore të miratuara, në një total prej 23 programesh (ku janë përfshirë edhe programet ku lëvrohen fondet e kushtëzuara), e më konkretisht disa nga programet më të rëndësishme janë:

- Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim”
- Programi “Menaxhimi i infrastrukturës së Ujitjes dhe kullimit”
- Programi “Administrimi i pyjeve dhe kullotave”

- Programi “Rrjeti rrugor rural”
- Programi “Shërbime publike vendore”
- Programi “Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë”
- Programi “Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” etj.

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Bashkia Mirditë mbi monitorimin e buxhetit për vitin 2022 ku janë përfshirë transfertat e kushtëzuara dhe fondet e deleguara dhe fondi i rindërtimit, situata realizimin e zërave buxhetorë për këtë bashki paraqitet si më poshtë, në mijë lekë:

	Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	% e realizimit
1	Shpenzime Personeli (600+601)	287,018	279,691	97.4%
2	Shpenzime Operative (602)	125,285	102,186	81.6%
3	Shpenzime të tjera korente(603-606)	427,120	398,174	93.2%
4	Shpenzime Kapitale (230-231)	1,273,961	1,212,269	95.2%
	TOTALI	2,113,384	1,992,320	94.3%

Mbështetur në informacionin dhe të dhënat e SIFQ për fondin e rindërtimit të cilin ka përfituar bashkia Mirditë gjatë vitit 2022, realizimi i këtij zëri buxhetor për këtë bashki paraqitet si më poshtë, në mijë lekë:

	Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	% e realizimit
1	Fonde rindërtimi (604)	54,853	31,239	57.0%
2	Fonde rindërtimi (231)	1,167,638	1,153,949	98.8%
	TOTALI	1,222,492	1,185,188	96.9%

Mbështetur në informacionin dhe të dhënat e SIFQ, pa përfshirë transfertat e kushtëzuara, fondet e deleguara dhe fondin e rindërtimit për vitin 2022, situata realizimin e zërave buxhetorë për këtë bashki paraqitet si më poshtë, në mijë lekë:

	Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	% e realizimit
1	Shpenzime Personeli (600+601)	281,452	274,338	97.5%
2	Shpenzime Operative (602)	123,782	100,821	81.5%
3	Shpenzime të tjera korente(603-606)	17,526	14,866	84.8%
4	Shpenzime Kapitale (230-231)	85,972	59,193	68.9%
	TOTALI	508,733	449,218	88.3%

Nga tabelat e mësipërme kuptojmë se pjesën më të madhe të realizimit e kanë investimet nga fondet e rindërtimit, ndërsa investimet nga fondet e vetë bashkisë janë realizuar rreth 69%. Sa i përket raportit që zënë zërat e shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve (pa përfshirë transfertat e kushtëzuara, fondet e deleguara dhe fondin e rindërtimit) rezulton se shpenzimet e personelit zënë 61.1%, Shpenzimet operative 22.4%, shpenzimet e tjera korente 3.3% dhe shpenzimet kapitale vetëm 13.2%.

Rekomandohet të punohet në drejtim të ndryshimit të këtyre raporteve, pasi rezulton që një pjesë e shumë e madhe e buxhetit të bashkisë Mirditë shkon për shpenzime personeli.

Në tërësi vlerësohet analiza e detajuar sipas programeve dhe lidhja e tyre me objektivat fillestare të buxhetit të bashkisë. Është e nevojshme që në raportet e monitorimit të

përmirësohet procesi i kostimit të treguesve dhe evidentimi në mënyrë të detajuar të punëve publike të realizuara sipas kostove përkatëse.

Duke analizuar Aneksin 5 mbi projektet e investimeve, vlen të theksohet fakti që bashkia Mirditë ka mbështetur një numër të lartë investimesh, projekte të cilat kanë rëndësi për zhvillimin e territorit të bashkisë, realizimi i të cilave në total për vitin 2022 është në vlerën 1,213 milion lekë.

3. Treguesit e performancës dhe statusi i produkteve kryesore

Në raportin e monitorimit të Bashkisë Mirditë, janë paraqitur indikatorët e performancës si dhe produktet e çdo programi në aneksin 3 dhe aneksin 4.

4. Informacion mbi detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtazi.

Në raportin e monitorimit të raportuar nga bashkia është përfshirë informacion i detajuar në lidhje me detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtazi, si dhe plani i hartuar për likuidimin e tyre. Trajtimi i detyrimeve të prapambetura duhet të konsiderohet prioritet.

5. Komentet tjera dhe rekomandime

- Në tërësi bashkia Mirditë ka bërë një punë shumë të mirë në realizimin e raportit të monitorimit për vitin 2022.
- Informacioni i përcjellë nga Bashkia Mirditë është paraqitur sipas kërkesave të anekseve të Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, me një relacion shoqërues të detajuar. Në plotësimin e Aneksëve të raportit, vlerësojmë që bashkia Mirditë ka ndjekur të gjitha kërkesat e udhëzimit standard të monitorimit duke plotësuar tabelat.
- Në raportin e monitorimit të raportuar nga Bashkia Mirditë është përfshirë informacion lidhur me detyrimet e prapambetura dhe të krijuara rishtazi. Rekomandojmë jo vetëm evidentimin e vlerës së detyrimeve të prapambetura, por edhe planin e hartuar për likuidimin e tyre. Trajtimi i detyrimeve të prapambetura duhet të konsiderohet prioritet.
- Rekomandojmë që monitorimi i realizimit të produkteve të realizuara për secilin program buxhetor të konvergojë dhe të jetë në përputhje të plotë me planifikimin buxhetor afatmesëm.

Publikimi në faqen e internetit

- Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit, në kuadër të transparencës si dhe në zbatim të nenit 48 pika 3 e ligjit nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, duhet të publikohet. Nga kontrolli në faqen zyrtare të bashkisë rezulton i publikuar raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022.